

**AKT THEMELIMI**  
**PËR SHOQËRINË TREGTARE**  
**“F. G. A.” Sh.p.k.**  
**ME SELI NË TIRANË**



Sot më datë 01.09.2004, Ortaku Themelues :

**Z. Artan GAÇI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.05.1969, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Blloku 50 Vjetori, Pall. 1, Shk. 2, Ap. 14, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr Z 0785875.

Ka shprehur vullnetin e tij për krijimin e shoqërisë me termat si më poshtë vijon:

**NENI 1.**

SHOQËRIA TREGTARE “F. G. A.” Sh.p.k. themelohet si Shoqëri Tregtare, bazuar në ligjin Nr.7638 datë 9.11 .1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

Ajo është Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën Bulevardi “Zogu i I”, Nr. 72.

**NENI 2.**

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e këtij akti themelimi, Statutit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Themeluesi i saj mban përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria.

**NENI 3.**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qindmijë) lekë i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale të një kuote 1000 lekë.

Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

1. **Zoti Artan GAÇI**, me cilësinë e Ortakut themelues, zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar është paguar nga Ortaku Themelues, në gjithë madhësinë e tij dhe në masën 100 % të vlerës së kapitalit.

**NENI 4.**

Shoqëria ka të depozituar në Bankën “Tirana Bank” me seli në Qytetin e Tiranës, kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë “Shoqëri në Formim e Sipër” dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi.

A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to Artan Gaci, the sole founder mentioned in the document.

Mbas regjistrimit të Shoqërisë kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj Shoqërie që do të çelet pranë Bankës "Tirana Bank" Tiranë.

Në llogarinë e Shoqërisë çelet llogaria "Fondi Themeltar i Ortakut" ku regjistrohet sasia e kapitalit të tyre.

#### **NENI 5.**

##### **Objekti i Veprimtarisë të shoqërisë.**

Shoqëria do të ketë si objekt të përgjithshëm të veprimtarisë së saj:

- Aktivitet në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm në to dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë;
- Prodhimi i materialeve të ndërtimit dhe atyre inerte të të gjitha llojeve, import – ekporti i materialeve të para dhe produkteve gjysëm të gatshme si dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit;
- Aktivitet në fushën e tregtisë së Bareve, Restoranteve e Hotelerisë, duke përfshirë këtu të gjitha ambjentet argëtuese në funksion të tyre, si disko, klube nate, e lojra të ndryshme argëtuese në funksion të tyre;
- Import-ekport dhe shitblerje me shumicë dhe me pakicë të mallrave industriale, melate me ngjyrë dhe të zeza, mallrave ushqimore, blektorale, bujqësore, materialeve të para, materialeve drusore dhe mobiljeve, por pa u kufizuar vetëm në këto;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Veprimtari në fushën e turizmit, me qëllim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike të pushimit, plazheve, qendrave të argëtimit brenda dhe jashtë vendit, të blejë, të marrë me qera, të ndërtojë apo të nxisë ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë e vetme apo me partnerë të tjerë;
- Import – eksport i automjeteve të të gjitha tonazheve, motoçikletave dhe i pjesëve të këmbimit për to, si edhe hapja e serviseve;
- Tregtimi i armëve të gjahut dhe i aksekorëve dhe i pajisjeve të nevojshëm të tyre.

Shoqëria do të kryejë aktivitetet si më sipër pas pajisjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse të lëshuara nga organet kompetente.

#### **NENI 6.**

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor të pa kufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar.

#### **NENI 7.**

Ortaku themelues mund të heqë dorë nga Shoqëria por gjithnjë për shkaqe të përligjura. Heqja dorë nuk e shkarkon Ortakun, nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

**NENI 8.**

Investimet dhe veprimtaria e Shoqërisë gëzojnë mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon të njëjtat kushte si për subjektet shqiptare ashtu edhe ato të huaja.

**NENI 9.**

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakut themelues. Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda edhe jashtë shtetit shqiptar.

**NENI 10.**

Ortakut Themelues ka si domos këto detyrime:

- Të regjistrojë Shoqërinë në Rregjistrin Tregtar dhe të marrë lejen e ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë së tyre.
- Të derdhë kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- Të sigurojë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, makineritë, lëndët e para e ndihmëse.
- Të sigurojë mundësitë e specializimit të fuqisë punëtore dhe specialistëve për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- Të sigurojë objektet dhe makineritë e Shoqërisë nga çdo lloj dëmtimi.
- Të menaxhojë prodhimin e ta reklamojnë atë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

**NENI 11.**

**Organet drejtuese të Shoqërisë janë :**

Asamblea e Ortakut të Vetëm

Administratori

Ekspertët Kontabël për rastet e parashikuara nga ligji.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë "F. G. A." Sh.p.k. do të jetë ortakut i vetëm themelues **Z. Artan GAÇI.**

**NENI 12.**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 13.**

Ortakut mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat.

**NENI 14.**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga Ortaku themelues i Shoqërisë dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.


Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrveshjeve është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

**NENI 15.**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u nënshkrua prej tij pa vërejtje para Noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES**

**Artan GAÇI**

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to read 'Artan Gaçi', is written over the printed name. The signature is fluid and cursive, with a prominent loop at the end.

**STATUTI  
I  
SHOQËRISË TREGTARE**

**“F. G. A.” Sh.p.k.**



Sot më datë 01.09.2004, Ortaku Themelues :

**Z. Artan GAÇI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.05.1969, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Blloku 50 Vjetori, Pall. 1, Shk. 2, Ap. 14, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr Z 0785875.

Ka shprehur vullnetin e tij për krijimin e shoqërisë me termat si më poshtë vijon:


### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare **“F. G. A.” Sh.p.k.** rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare

#### **NENI 1.**

**Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë :**

- Aktivitet në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm në to dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë;
- Prodhimi i materialeve të ndërtimit dhe atyre inerte të të gjitha llojeve, import – ekporti i materialeve të para dhe produkteve gjysëm të gatshme si dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit;
- Aktivitet në fushën e tregtisë së Bareve, Restoranteve e Hotelerisë, duke përfshirë këtu të gjitha ambientet argëtuese në funksion të tyre, si disko, klube nate, e lojra të ndryshme argëtuese në funksion të tyre;
- Import-ekport dhe shitblerje me shumicë dhe me pakicë të mallrave industriale, melate me ngjyrë dhe të zeza, mallrave ushqimore, blektorale, bujqësore, materialeve të para, materialeve drusore dhe mobiljeve, por pa u kufizuar vetëm në këto;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Veprimtari në fushën e turizmit, me qëllim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike të pushimit, plazheve, qendrave të argëtimit brenda dhe jashtë vendit, të blejë, të marrë me qera, të ndërtojë apo të nxisë ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë e vetme apo me partnerë të tjerë;
- Import – eksport i automjeteve të të gjitha tonazheve, motoçikletave dhe i pjesëve të këmbimit për to, si edhe hapja e serviseve;



Tregtimi i armëve të gjahut dhe i aksekorëve dhe i pajisjeve të nevojshëm të tyre.

Shoqëria do të kryejë aktivitetet si më sipër pas pajisjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse të lëshuara nga organet kompetente.

**NENI 2**

**Emri dhe selia e Shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emrin e saj "F. G. A." Sh.p.k.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Bulevardi "Zogu i I", Nr. 72, Tiranë Shqipëri.

**NENI 3.**

**Regjimi Juridik i Shoqërisë.**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Ortakut, Shoqëria mundet që të ndryshojë rregjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT.**

**NENI 4.**

Ortaku mban përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakut. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakut Themelues.

**NENI 5.**

**Të drejtat e Ortakut.**

Ortaku ka të drejtë të administrojë aktivitetin e Shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryejë, vlerat e saj intelektuale e ekonomiko - financiare. Marrja dijeni për rezultatet ekonomiko - financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Marrja pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.

Ka të drejtë të tërheqë të gjithë dokumentat kryesore të Shoqërisë për tre vitet e fundit. Marrja nga Administratori i Shoqërisë, 15 ditë para çdo mbledhjeje asamblejeje, materialet e saj dhe projektet e vendimeve.

Të heqë dorë nga Shoqëria dhe mund të shesë kapitalin e tij, në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji.

Heqia dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqies dorë dhe nuk e çënon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment. Në rastin e heqies dorë ai mund t'i ofrojë kapitalin çdo personi tjetër të mundshëm.

Ortaku në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi ka të drejtë, që në të njëjtën kohë të jetë Ortakë edhe në Shoqëri të tjera.

Ortaku ka të drejtë që të paraqesë propozime për shqyrtime para organeve të Shoqërisë si dhe të emërojë e shkarkojë Administratorin ose Administratorët, të punësuarit, ekspertin kontabël apo likuidatorët.

#### **NENI 6.**

**Ortaku ka edhe këto detyrime kryesore :**

- Të depozitojë kapitalin e Shoqërisë brenda afatit të parashikuar.
- Të përpiqet për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.
- Të informojë organet drejtuese të Shoqërisë për mundësitë e përmirësimit të aktivitetit të saj.
- Të marrë pjesë në procesin e rritjes së nivelit të specialistëve.
- Të respektojë detyrimet që burojnë nga ligji, Akti i Themelimit dhe Statuti.

#### **NENI 7.**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pakufizuar.

#### **NENI 8.**

Ndalohet emetimi i letrave me vlerë si dhe garantimi i emisioneve të letrave me vlerë.

### **III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**


#### **NENI 9**

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe paqyrohet në bilancet e saj.

#### **NENI 10**

Kapitali fillestar i investuar nga Ortaku, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Administratori i dorëzon Ortakut dokumentin vërtetues për sasi të shumave të derdhura në fazën e themelimit.



Vlerësimi i kapitalit në natyrë është bërë nga Ortaku Themelues në momentin e themelimit të Shoqërisë.

#### NENI 11

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakut themelues në vlerën 100.000 lekë (njëqindmijë) i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale të një kuote 1000 lekë. Kuotat janë me vlerë nominative. Kapitali themeltar ndahet në kuota me shumë jo më të vogël se 1000 lekë.

Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

1. **Zoti Artan GAÇI**, me cilësinë e Ortakut themelues, zotëron 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet që të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga Ortaku themelues dhe të shlyhen krejtësisht prej tij, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në para ashtu edhe në natyrë. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime.

#### NENI 12

##### **Pasuria e Shoqërisë**

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla. Shoqëria nuk ka detyrimin e nuk përgjigjet për kthimin e kompensimin e tokës së blere nga shteti tek ish-pronarët.

#### NENI 13

##### **Trasferimi i kuotave tek pasardhësit, parardhësit dhe bashkëshorti.**

Kuotat e Ortakut mund të transferohen lirisht tek trashëgimtarët ligjore e testamentarë të tij mbas vdekjes si dhe tek bashkëshorti tjetër me rastin e zgjidhjes së martesës.

Subjektet që përfitojnë nga ky transferim detyrohen të disponojnë kapitalin e transferuar për një vit në Shoqëri, duke pasur të gjitha të drejtat e mbajtësit të tij të mëparshëm.

#### NENI 14

Ortaku mund të transferojë lirisht kapitalin themeltar edhe tek bashkëshorti, tek pasardhësit e paraardhësit, të cilët detyrohen që për një vit ta disponojnë këtë kapital në shoqëri.

#### NENI 15.


##### **Forma e transferimit**

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial, ndryshe janë të pavlefshme.

#### NENI 16.

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet kur për këtë vendos Ortaku themelues.



Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakut.

Ortaku themelues, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

#### **NENI 17.**

##### **Fondet rezerve**

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

#### **NENI 18.**

##### **Përdorimi i të ardhurave neto.**

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortaku, sipas qëllimit të tij.

#### **NENI 19.**

##### **Bilanci**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakut ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 20**

##### **Plani financiar.**

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

### **IV. ORGANET E SHOQËRISË.**

#### **NENI 21.**

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Ortakut të Vetëm. Mbledhja mund të mbledhet në çdo kohë kur organi administrativ ose vetë ortaku e shikojnë të nevojshme.

Asambleja e Ortakut të Vetëm vendos për të gjitha problemet me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga Statuti.

## V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 22.

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori. Administratori ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligja ja atribuon Ortakut të Vetëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë në mardhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrativ. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit. Administratori shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Përveç kësaj Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata me kërkesë të Ortakut të Vetëm. Ortaku ka të drejtë që të marrë nga Administratori të dhëna për zhvillimin e punëve dhe të shikojë librin e Shoqërisë. Administrator i Shoqërisë "F. G. A." Sh.p.k. do të jetë ortaku i vetëm Zoti Artan GAÇI.

### NENI 23

Administratori ka këto kompetenca kryesore :

- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe t'i paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Të bëjë propozimet përkatëse Ortakut kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë, duke përfshirë kuadrin e personelin.
- Të përfaqësojë Shoqërinë në mardhënie me të tretët.
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- T'i propozojë Ortakut të Vetëm për krijimin e njësive, strukturave të ndryshme si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'i paraqesi Ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve në Shoqëri.

### NENI 24.

#### Ekspertët Kontabël.

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Caktimin e tyre e bën Mbledhja e Ortakut të Vetëm. Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund ta kryejnë këtë detyrë përgjegjësit e zyrave, filialeve e agjensive.

## VI. MARRDHËNIET E PUNËS.

### NENI 25.

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

### NENI 26.

Kontrata individuale e punës rregullon këto marrdhënie:

Marrja në punë, kushtet e të punësuarit për tu marrë në punë.

Lloji i punës që do të kryejë i punësuarit, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore e javore, pushimi ditor e javor, shpërblimi për kohën e punës, për periudhën jashtë kohës normale të punës, për punën e natës, për ditët e pushimit dhe të festave, shpërblimi për punë të dalluar. Përgjegjësitë e palëve për mos respektimin e kontratës.

### NENI 27.

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

## VI. MBYLLJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

### NENI 28.

Veprimtaria e Shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur Shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos Gjykata kompetente.


### NENI 29.

Kur vendoset shkrirja e Shoqërisë, mbi propozimin e Administratorit, Mbledhja e Asamblesë të Ortakut të Vetëm cakton likuidatorin që realizon likuidimin e saj. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit edhe emrin "Shoqëri në Likuidim e Sipër".

Me miratimin e likuidimit Shoqëria i jep fund veprimtarisë.

### NENI 30.

Asambleja e Ortakut të Vetëm vendos mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.



Asambleja e Ortakut të Vetëm mund të kërkojë edhe vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga Gjykata mbi propozimin e Ortakut ose të një mandatmbajtësi.

**NENI 31.**

Kur Asambleja e Ortakut të Vetëm, pa shkaqe të arsyeshme nuk vendos për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likujdimit.

Aktet e mbylljes së likujdimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në regjistrin tregtar.

Mbas mbylljes së likujdimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar, Shoqëria çregjistrohet prej tij.

## **VII. DISPOZITA TË FUNDIT.**

**NENI 32.**

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Asambleja e Ortakut të Vetëm, e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

**NENI 33.**

Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**Artan GAÇI**

